



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues i KQZ-së**  
Prof. ass. dr. Arbnor Ajeti

Nr. Prot. 885 Dt 18.04.2023

## **Udhëzimet për vend votim**

Në mënyrë që të behët mbarëvajtja e rregullt e votimit dhe numërimit të votave në zgjedhjet studentore të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicës në nivel Parlamenti Studentor dhe Këshilla Fakultetesh, vend votimet në vijim janë përcaktuar dhe adaptuar bazuar në rregulloren për zgjedhjet studentore të UIBM të vitit 2021,

### **A. Përgatitjet para ditës së zgjedhjeve**

1. Komisioni Zgjedhor duhet të caktojë të gjithë anëtarët e Komisioneve të Vend Votimeve (KVV).
2. Anëtarët e KVV do të nënshkruajnë Kodin e mirësjelljes.
3. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i vend votimit do të kenë një trajnim për udhëzimet e vend votimit.
4. Kryesuesi do të pranojë materialet e nevojshme për të zhvilluar trajnimin në vend votim.
5. Pjesa tjetër e anëtareve të komisionit të vend votimit duke përfshirë edhe ndonjë anëtarë rezervë do të mbajnë një trajnim i cili do të mbahet nga kryesuesi apo i përcaktuari.
6. Kryesuesi do të përcaktojë detyrat dhe pozitat për secilin anëtarë të KVV.
7. Anëtarët e KVV do të vendosin dhe rregullojnë vend votimin e tyre.
8. Kryesuesi do ti pranojë materialet që janë të nevojshme për zhvillimin e procesit të votimit në vend votim.

### **B. Para hapjes së vend votimit**

1. Të gjithë anëtarët e KVV duhet të arrijnë në vend votim një orë para fillimit të hapjes së vend votimit. Nëse nuk janë të pranishëm anëtarët e KVV në kohën e duhur, atëherë kryesuesi ka të drejtë të i kërkojë anëtarët rezervë.
2. Nëse Kryesuesi nuk arrin në vendvotim me kohë, atëherë zëvendës kryesuesi do të merr përgjegjësitë e tij/saj.
3. Secilit vëzhgues do ti lejohet të hyjë në vend votim për të vëzhguar procedurat e hapjes së vend votimit.
4. Kryesuesi do të shpërndajë materialet e votimit te anëtarët përkatës. Secili anëtarë i KVV duhet të përgatitë në mënyrë të duhur materialet për votim.
5. Kryesuesi do të regjistrojë në protokollet e votimit informacionin e nevojshëm para hapjes së vend votimit.
6. Zyrtari i kutisë të votimit do të prezantojë së pari kutinë e zbrazët para secilit që është i pranishëm dhe para Kryesuesit i cili pastaj do ti lidhë (vulosë) kapakun e kutisë së votimi.
7. Kryesuesi do të shpallë para të pranishmëve hapjen e vend votimit dhe do të kërkojë nga Zyrtari për Rend që të lejojë studentët të hyjnë sipas radhës në vend votim.
8. Qendrat e vendvotimeve në të gjitha njësitë akademike hapen në ora 8:00. Vonesa eventuale në hapjen e vendvotimit, pas orës 8:00, duhet të shënohet në protokollin e vendvotimit dhe të ceken arsyet.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**C. Mbajtja e votimit**

1. Zyrtari për Rend do të mirëmbajë rendin në vend votim duke siguruar që hyrja e studentëve në vend votim të bëhet sipas radhës dhe ti drejtojë studentët te Zyrtari Identifikues.
2. Zyrtari për Rend duhet të sigurohet që para hyrjes studenti të ketë ID e studentit dhe të verifikojë në formën e duhur nëse votuesi ka votuar më herët.
3. Një student sipas radhës mund të procedojë te Zyrtari për identifikim, i cili do të verifikojë identitetin e studentit duke inspektuar foton dhe emrin ashtu si është në ID të studentit.
4. Studentët që kanë pengesa fizike, nga të cilët nuk pritët se do të mund të votojnë vetëm, duhet të përcillen të njëjtat procedura, përveç se ata/ato mund të zgjedhin një përcjellës i cili/cila mund t'i mbështesë gjatë procesit elektoral. Përcjellësi i studentit me aftësi të kufizuara mund të ketë të drejtë të votojë mirëpo duke iu përmbajtur të gjitha procedurave të votimit për studentët me të drejtë vote.
5. Zyrtari Identifikues do të gjejë emrin e studentit në Listën e Studentëve me të Drejt Vote dhe kërkon nga votuesi që të nënshkruhet pranë emrit të tij / saj.
6. Nëse emri i studentit nuk gjendet në listën e studentëve me të drejtë vote, ai nuk do të ketë të drejtë vote me kusht, sepse i është dhënë kohë e mjaftuar për ankesë në rast të mungesës së emrit në listën e studentëve me të drejtë vote.
7. Zyrtari Identifikues do ta përcjell ID e studentit te Zyrtari i Fletëvotimeve.
8. Zyrtari i fletëvotimeve spërkatë gishtin tregues të dorës së djathtë të votuesit.
9. Zyrtari i Fletëvotimeve do të para-palosë dhe vulosë pjesën e pasme të fletëvotimit i cili pastaj do ti dorëzohet studentit.
10. Zyrtari i Fletëvotimit do t'ia jap në dorë fletëvotimin studentit.
11. Zyrtari regjistruar do të shënoj ID e votuesit dhe ia kthen votuesit përkatës.
12. Pastaj, Zyrtari i Fletëvotimit do të drejtojë votuesin te vendi i votimit.
13. Vetëm një votues lejohet të jetë i pranishëm në kabinën e votimit gjatë votimit. Përcjellësi i votuesit me aftësi të kufizuara nuk mund të votojë në të njëjtën kohë me aftësi të kufizuara në të njëjtën kabinë votimi derisa e bënë përcjelljen.
14. Me kërkesë të votuesit, mirëpo para se votuesi të futë votën në kutin e votimit, votuesi ka të drejtë të marrë edhe një fletëvotim zëvendësues nëse ai/ajo ka bërë ndonjë gabim gjatë vendosjes së shenjës në fletëvotim. Votuesi duhet ta shqyjej fletëvotimin e dëmtuar në prani të Zyrtarit të Fletëvotimit.
15. Zyrtari i Fletëvotimit do të merr fletëvotimin e shqyer, ta vendos atë në një zarf, ia jep votuesit fletëvotimin e zëvendësuar të palosur dhe të vulosur dhe e ridrejton te vendi i votimit.
16. Dorëzimi i fletëvotimit të zëvendësuar duhet të regjistrohet në protokollin e votimit nga Kryesuesi.
17. Zyrtari i Fletëvotimit do të hapë kapakun e kutisë së votimit duke u siguruar që votuesi e depoziton votën e palosur të vulosur në kutinë e votimit.
18. Pas procesit të votimit studenti duhet të dalë nga vendvotimi pa vonesë.

**D. Mbyllja e Vendvotimit**

- Mbyllja e vend votimit do të bëhet pas përfundimit të periudhës zgjedhore në ora 17.00.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

---

1. Kryesuesi i Vendvotimit do të deklarojë mbylljen e votimit pas përfundimit të periudhës së votimit. Secili student që mund të jetë në rend në kohën e mbylljes mund të procedojë te Zyrta e Identifikues derisa të përfundojë votimin edhe votuesi i fundit, pastaj kapakët e kutive të votimit do të mbyllën (lidhën) nga Kryesuesi i vend votimit. Vetëm anëtarët e KVV, Komisioni Zgjedhor, Komisioni i Fakultetit, Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave mund të mbesin brenda vend votimit pas mbylljes së saj.

2. Kryesuesi i KVV duhet të regjistrojë procedurat e zgjedhjes dhe rezultatet e zgjedhjes në Protokollin e Procedurave të Zgjedhjeve.

3. Regjistrimi i këtyre çështjeve si më poshtë duhet të bëhet në raportin e Protokollit të Procedurave Zgjedhore, nëse nuk është bërë më parë apo gjatë procesit të zgjedhjeve.

- Emri i lokacionit të zgjedhjeve, numri dhe data e vend votimit,
- Emrat e anëtarëve të pranishëm dhe atyre që mungojnë të KVV,
- Emrat e vëzhguesve të pranishëm,
- Numri i saktë i fletëvotimeve të dorëzuara,
- Orën e saktë të hapjes dhe të mbylljes së vend votimit,
- Vendimin e KVV në lidhje me kundërshtimin e ndonjë studenti pa të drejt vote.
- Vendime tjera gjatë periudhës së zgjedhjeve, dhe
- Çdo përcaktim sa i përket pikave paraprake.

### **E. Numërimi i Votave**

1. Kryesuesi duhet të këpus lidhëset e kutive të votimit, të i përziej votat në kutinë e votimit dhe pastaj të zbrazë votat nga kutia e votimit dhe të numëroj:

- a. Numrin e përgjithshëm të votave për secilin organ që është votuar
- b. Numrin e përgjithshëm të votave të regjistruara në regjistrin e votave
- c. Identifikon arsyet e ndonjë mospërputhje në mes a & b

-d. Ky informacion duhet të regjistrohet në Protokollin e Procedurës Zgjedhore.

2. Me dy zgjedhje në një fletëvotim, është e domosdoshme gjatë procedurës së numërimit që secila zgjedhje të numërohet ndarazi nga tjetra. Së pari numëroni votat për Parlament Studentor, i vendosni të dhënat e përgjithshme në tabelë dhe pastaj numëroni votat për Këshill të Studentëve.

3. Anëtarët e KVV të përcaktuar për numërim duhet të shpalosin secilin fletëvotim të vulosur dhe të vendosin fletëvotimet në anën e prapme. Ktheni fletëvotimet nga ana e përparme duke filluar identifikimin e fletëvotimeve të pa vlefshme sipas numrit të radhës dhe pastaj numëroni:

- Numrin e përgjithshëm të votave,
- Numrin e përgjithshëm të votave jo të vlefshme,
- Numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme, dhe
- Numrin e përgjithshëm të votave për secilën organizatë studentore.

\* **Mbani mend:** Fletëvotimet e pavulosura konsiderohen të pavlefshme nëse numri i fletëvotimeve të depozituara në kutin e votimit e tejkalon numrin e votuesve që është regjistruar në regjistrin e votave.

4. Fletë votimi njihet si i vlefshëm, nëse aty ka evidencë të pa diskutueshme për organizatën studentore apo kandidatin të cilin votuesi e ka zgjedhur. Ky është rasti kur votuesi markon qarkun



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

e emrit të organizatës së pranueshme apo kandidatit me një kryq apo shenja tjera të kësaj natyre, në mënyrë që qëllimi i votuesit për të zgjedhur këtë organizatë apo kandidatë tregohet me qartësi.

5. Fletëvotimet konsiderohen si jo të vlefshme, nëse:

- Përdorët edhe një fletëvotim përveç fletë votimit zyrtar
- Fletëvotimi është i pavulusur dhe e tejkalon numrin e votuesve,
- Fletëvotimi është shqyer në aso mënyrë që e bënë të paqartë qëllimin e votimit të votuesit në të dy anët e fletëvotimit,
- Kur asnjëra organizatë nuk markohet me shenjë me saktësi për të dy zgjedhjet,
- Kur më shumë se një organizatë është votuar për një zgjedhje, apo
- Kur qëllimi i votuesit nuk është i përcaktuar me saktësi për një zgjedhje

6. Hapat 3 – 5 do të përsëritën edhe gjatë numërimit të pjesës së votave për Këshill të Studentëve.

7. Në përfundim të numërimit dhe vetëm atëherë kur të kompletohen të gjithë formularët me saktësi, kryesuesi do të njoftojë Komisionin Zgjedhor për rezultatet dhe që Procedurat Paketimit kanë filluar.

8. Çdo variant i këtyre procedurave duhet të regjistrohet në Protokollin e Votimit nga Kryesuesi.

### **Paketimi dhe Udhëzimet për Transport**

Paketimi i duhur është çështje kyçe për procedim efikas të materialeve të Vend Votimit deri në lokacionin qendror.

Materialet duhet të paketohen dhe transportohen sipas procedurave të më poshtme në mënyrë që të lehtësojnë përmbylljen e materialeve dhe verifikimin e rezultateve.

### **Etiketimi**

Saktësia e etiketimit të gjitha zarfeve dhe thasëve duhet të konfirmohet nga kryesuesi. Materialet si në vijim duhet të kenë Kodin e Vend Votimit i cili duhet të regjistrohet nga Kryesuesi apo i përcaktuari:

- Thesi i cili përmban fletëvotimet e papërdorura,
- Thesi i cili përmban fletëvotimet e vlefshme dhe të numëruara,
- Zarfi i cili përmban fletëvotimet e dëmtuara (prishura),
- Zarfi që përmban fletëvotimet jo të vlefshme,
- Të gjithë formularët e kompletuar,
- Protokollet e votimit,
- Listën e Studentëve me të drejt vote,
- Regjistri i Votimeve,
- Kutinë e votimit, dhe të materialeve

\*Përveç kodit të vend votimit, këto materiale duhet të kenë sasinë e të gjitha atyre që janë regjistruar nga kryesuesi apo i përcaktuari:

- Thesi i cili përmban fletëvotimet e papërdorura,
- Thesi i cili përmban fletëvotimet e vlefshme dhe të numëruara,
- Zarfi i cili përmban fletëvotimet e dëmtuara (prishura), dhe
- Zarfi që përmban fletëvotimet jo të vlefshme.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

---

### **DIAGRAMI I PAKETIMIT – Paketimi**

Pasi që të gjithë thasët dhe zarfet të etiketohen në mënyrë të duhur, në përfundim të procesit:

1. Në kutinë e materialit vendoset materiali i zyrës kurse
2. Në kutinë e votimit vendosen:
  - Thesi që përmban fletëvotimet e papërdorura
  - Thesi që përmban fletëvotimet e vlefshme të numëruara
  - Zarfi që përmban fletëvotimet e dëmtuara
  - Zarfi që përmban fletëvotimet e pavlefshme
  - Protokollin e votimeve
  - Lista e studentëve me të drejtë vote – regjistri i votuesve
  - Formulari i ankesave të përfunduara
  - Rripat mbyllës të sigurisë të papërdorur
  - Formulari i rezultateve.

### **Lidhja**

Para se të lidhet kutia e votimit, Kryesuesi duhet të ndajë lidhëset e nevojshme për lidhjen e kutisë dhe ti regjistrojë shifrat e lidhësve në protokollin e votimit. Kryesuesi do të rishikojë procedurat dhe diagramin e paketimit për tu siguruar që çdo gjë është përmbyllur sipas procedurave, dhe pastaj e lidhë kutinë për transportim.

### **Detyrat përfundimtare të vend votimit**

Vend votimi duhet të lirohet i pastër, duke vendosur pajisjet në vendin e duhur, çdo lloj shirit duhet të largohet nga muret dhe dyshemeja dhe të gjithë posterët dhe copëzat që kanë të bëjnë me zgjedhjet të largohen plotësisht.

### **Transporti**

Kryesuesi pasi të ketë përgatitur kutinë e votimit dhe kabinën e votimit i dërgon ato në lokacionin qendrorë.

